



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA KURBIN

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 82/Prot.  
2

Laç më 29.022024

VENDIM

NR. 70 .DATË 23.02.2024

**“PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT”**

Në mbështetje të nenit 15 të ligjit nr.139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; nenit 15, neni 16 ligjit nr. 22/2018 “ Për Strehimin Social” i ndryshuar; VKM nr.384 datë 12.06.2019 “ Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo program social të strehimit dhe te afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 362, datë 29.5.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKM nr. 453, datë 3.7.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, VKM-së nr.405, datë 01.06.2016 “Për miratimin e strategjisë të strehimit social 2016-2025” pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, pas propozimit nga Kryetari i Bashkisë dhe komisioni i strehimit, Këshilli Bashkiak:

**VENDOSI;**

1. Të miratojë sistemin e pikëzimit për programin “ Banesa sociale me qira/ subvencionimi i qirasë sipas Aneksit 1, bashkelidhur.
2. Të miratojë sistemin e pikëzimit për programin “Banesa me kosto të ulët/ subvencionim i interesave të kredisë” sipas Aneksit 2, bashkelidhur

**Aneksi nr.1 – SISTEMI I PIKËZIMIT PËR PROGAMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA/SUBVENCIONIMI I QIRASË**

	<b>Kriteret e Pikëzimit</b>	<b>Pikët</b>
<b>A</b>	<b>Kushtet e strehimit</b>	<b>25</b>
i	Nuk disponojnë banesë në pronësi	7
ii	Banojnë në banesa në rrezik shembje	6
iii	Banojnë në banesa të mbi populluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	4

**-Mënyra e vlerësimit dhe llogaritja:**

Në llogaritjen e pikëve për individët/ familjet aplikuese, Komisioni i Strehimit duhet të marrë në konsideratë rregullat e mëposhtme:

**I.** Pikët maksimale që mund të përfitojë një individ/familje janë 100 pikë. Nuk mund të mblidhen brenda për brenda një kriteri.

Sistemi i pikezimit duhet të përmbajë 100 pikë, ku çdo kriter i përcaktuar në nenin 16 të L.22/2018 i ndryshuar, përmban 25 pikë.

Kjo mënyrë llogaritje pikësh aplikohet për të gjitha programet e strehimit social.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

>Prefekti I Qarkut Lezhë

>Drejtoria e Sherbimeve Publike

>Arkivi

Sekretari i Këshillit

Arber Leka



Kryetari e Këshillit

Edlira Lleshi

